



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**

Nr. 2361/3 /Prot.

Tiranë, më 09/01 /2024

**OFERTE – PUNE**

Universiteti Bujqësor i Tiranës shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik, kategoria "Asistent-Lektor" në Departamentin e Pyjeve pranë Fakultetit të Shkencave Pyjore, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Konkursi do të zhvillohet në godinën B, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (kati I), Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike në datën 13/02/2024 në orën 12.<sup>30</sup>.

Të interesuarit do të dërgojnë dokumentacionin e nevojshëm në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike të Universitetit Bujqësor të Tiranës jo më vonë se data 07/02/2024.

Kriteret e përgjithshme dhe dokumentacioni i nevojshëm janë të bashkëngjitura.

**ADMINISTRATORI**

**Edmond TËRTHORJA**

**REKTORI**

**Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 2361/4 Prot.

Tiranë, më 09/01/2024

**Lënda:** Kriteret e vlerësimit të kandidatëve që konkurrojnë për vend të lirë pune personel akademik 2 (dy) "Asistent-Lektor" në Departamentin e Pyjeve, pranë Fakultetit të Shkencave Pyjore (FSHP).

**POZICIONI:** "Asistent-Lektor" në Departamentin e Pyjeve, pranë Fakultetit të Shkencave Pyjore.

Në përputhje me neni 57, pika 2 dhe pika 3 dhe neni 64, të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22/7/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", me nenin 36, pika 2 dhe nenin 29, pika 2 të Statutit e UBT-së të miratuar me Urdhër Nr. 279, datë 28.07.2021 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Rregulloren e Rekrutimit të Stafit Akademik & Ndhmës në UBT si dhe shkresa e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Pyjore, konfirmuar nga Rektori, me Nr. 2361/2 Prot. datë "Mbi plotësimin e 2 (dy) vendeve të lira pune si personel akademik "Asistent-Lektor" për modulet Gjeodezi dhe Mbritshmëria Pyjore; në FSHP, shpallen për t'u plotësuar nga kandidatët që do të konkurrojnë, kriteret e vlerësimit si më poshtë:

### I. KRITERE TE PERGJITHESHME

I	KRITERE – ELIMINUESE
1	1.a Të jetë diplomuar në sistemin me kohë të plotë në të dy nivelet: Bachelor dhe Master Shkencor, ose me Diplomë të Integruar të Ciklit të dytë në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës në Inxhinieri Gjeodezi ose në universitete të tjera jashtë vendit që ofrojnë diploma të ngjashme. 2.b Të jetë diplomuar në sistemin me kohë të plotë në të dy nivelet: Bachelor dhe Master Shkencor, ose me Diplomë të Integruar të Ciklit të dytë në profilet "Inxhinieri Pyjesh" në Fakultetin e Shkencave Pyjore, Universiteti Bujqësor i Tiranës ose në universitete të tjera jashtë vendit që ofrojnë diploma të ngjashme.
2	Të kenë notë mesatare të shkollës së lartë mbi 8.00, si mesatare të dy cikleve të studimit: Bachelor dhe Master Shkencor. Në rastet kur kandidati ka notën mesatare 10.0, ai rekrutohet pa konkurim.
3	Në pozicionin "Asistent-Lektor" mund të konkurojnë vetëm kandidatët që kanë fituar një diplomë të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave". Mosha më i/e vogël ose 30 vjeç.
<b>Shënim:</b> Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.	

## II. KRITERE TE VEÇANTA

I	KRITERE PËR VLERËSIMIN NË E DOSJES SË KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
1	<b>Shkollim dhe kualifikim të mëtejshëm:</b>	
	• Master jashtë vendit (brenda fushës që konkurron)	5
2	<b>Përvojë pune në fushën e studimit dhe mësimdhënie</b>	
	• Për çdo dy vjet eksperiencë në mësimdhënie në universitet (kohë e plotë).	2
	• Për çdo eksperiencë në mësimdhënie në universitet (pedagog i ftuar).	1
3	<b>Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit</b>	
	• Për kurs kualifikimi brenda vendit (të vërtetuar me dëshmi ose dokumente të tjera) nr. 1 Kurs= 1 pikë për secilin.	1
	• Për kurs kualifikimi jashtë vendit (të vërtetuar me dëshmi ose dokumente të tjera), nr. 1 Kurs=2 pikë për secilin.	2
4	<b>Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht) e vërtetuar me dëshmi nga kurset internac. (nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri)</b>	
	• Gjuhë Angleze, niveli C1.	20
	• Gjuhe të tjera. Niveli ekuivalent me C1 në gjuhën Angleze : Italisht, Gjermanisht, Frëngjisht dhe Spanjisht.	10
5	<b>Pjesëmarrje në konferenca brenda dhe jashtë vendit</b> <b>Referime në:</b>	
	• Sesione shkencore & konferenca & kongrese brenda vendit, numër pjesëmarrjesh, me botim në proceedings (autor i parë).	5
	• Sesione shkencore & konferenca, kongrese jashtë vendit, numër pjesëmarrjesh, me botim në proceedings (autor i parë).	10
6	<b>Aftësi në programe kompjuterike (me dëshmi përkatëse)</b>	2
<b>TOTALI PIKEVE TË DOSJES: (70%) e Totalit prej 100 pikësh (max 70 pikë)</b>		
<b>TOTALI PIKEVE NGA INTERVISTA ME GOJË: (30%) e Totalit prej 100 pikësh (max 30 pikë)</b>		

### Shënim:

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore & Shërbimeve Juridike dhe Komisioni i rekrutimit bëjnë vlerësimin e dosjes sipas përcaktimeve të mësipërme.
- Totali i pikëve të kandidatit është shuma e pikëve të vlerësimit të dosjes me pikët nga intervista me gojë.

### Kujdes & Konsideroni:

- Konferenca ndërkombëtare do të konsiderohen të gjitha ato që zhvillohen (i) jashtë shtetit me bord organizator dhe shkencor dhe proceedings nga një Universitet ose Institucionin tjetër ndërkombëtar dhe

(ii) ato qe organizohen ne Shqipëri nga njeri nga Universitetet Publike te Tiranës (UBT, UT, UP) me bord organizator dhe shkencor dhe proceedings; qe përmban titullin ndërkombëtar ne te cilin marrin pjese kërkues nga shume vende.

- Në kushtet kur kandidatët kanë pikë të barabarta preferohet kandidati që ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Doktoratë jashtë vendit.
- Në kushtet kur njoftimi për shpalljen e vendit vakant është publikuar 1 herë, dhe është anuluar për arsye të mungesës së numrit të kërkuar të kandidatëve, procedura e konkursit mund të zhvillohet brenda kritereve të përcaktuara edhe me një kandidat.

**REKTORI**

**Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 2361/5 Prot

Tiranë, më 29/01 /2024

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT  
QË KONKUROJNË**

1. Kërkesën për vendin e punës që do të konkurrojnë.
2. Dokumentin e identifikimit.
3. CV me fotografi.
4. Diplomën të shoqëruar me listën e notave.
5. Kandidatët që kanë mbaruar jashtë vendit, duhet të kenë bërë njohjen e diplomës.
6. Librezën e punës.
7. Librezën e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore.
8. Dy referenca nga punëdhënësi ose nga pedagogë për të sapodiplomuarit.
9. Dëshmitë e gjuhëve të huaja të niveleve të përcaktuara tek kriteret.
10. Formularin e vetdeklarimit (te shkarkohet nga faqja e DAP-it).
11. Deklaratën personale që nuk ka konflikt interesi.
12. Raportin mjekësor për aftësinë në punë.
13. Dëshmi penaliteti për punë
14. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
15. Vërtetim nga prokuroria.
16. Dokumentacioni duhet të jetë i noterizuar, kur nuk është në original.

REKTORI

Prof. Dr. Fatbardh SAJLAJ

